



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LIGJI Nr. 03/L-213**

**PËR KOMPONENTIN REZERVË TË FORCËS SË SIGURISË SË  
KOSOVËS**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR KOMPONENTIN REZERVË TË FORCËS SË SIGURISË  
SË KOSOVËS**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë ligj përcaktohet korniza ligjore për rregullimin e shërbimit të Komponentit Rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, si pjesë e uniformuar e strukturës së FSK-së.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Ky ligj rregullon përbërjen, kushtet e shërbimit, të drejtat dhe përgjegjësitë individuale, përgjegjësitë e punëdhënësit dhe procedurat e mobilizimit në Komponentin Rezervë të FSK-së.

### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **FSK** – Forca e Sigurisë së Kosovës

1.2 **MFSK** – Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

1.3. **Mobilizim**” – Organizimi i gjithë apo një pjese të Komponentit Rezervë të FSK-së për të marrë pjesë në operacionet për reagim ndaj krizave, duke përfshirë edhe operacionet në mbështetje të paqes dhe për të ndihmuar autoritetet civile për t’iu përgjigjur katastrofave natyrore dhe emergjencave të tjera.

1.4 **Pjesëtar Aktiv i FSK-së** – Pjesëtari i cili shërben me orar të plotë në FSK.

1.5 **Pjesëtar Rezervë i FSK-së** - Pjesëtari, puna dytësore e të cilit është shërbimi në FSK. Pjesëtari Rezervë është pjesëtar aktiv i FSK-së gjatë trajnimit apo mobilizimit.

1.6. **Punëdhënësi primar** - Person fizik apo juridik me të cilin pjesëtari rezervë i FSK-se mund të këtë marrëdhënie të rregullt pune.

1.7. **Rezerva e FSK-së**” – Komponentin Rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

### **Neni 4 E drejta për konkurrim dhe përbërja e Rezervës së FSK-së**

1. Të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës kanë të drejtë të konkurrojnë në Rezervën e FSK-së, nëse plotësojnë kriteret siç janë të përcaktuara në këtë ligj dhe në Ligjin për Shërbim në FSK.

2. Rezerva e FSK-së përbëhet prej maksimum tetëqind (800) pjesëtarësh.

### **Neni 5 Kushtet e Shërbimit**

1. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së shërben më së shumti tridhjetegjashtë (36) ditë në vit, për t’u trajnuar dhe përgatitur për operacione.

2. Si përjashtim nga paragrafi 1. i këtij neni, pjesëtarit të Rezervës së FSK-së mund t’i kërkohet që të shërbejnë më shumë se tridhjetegjashtë (36) ditë në vit, në rastet kur:

2.1. mobilizohet për të marrë pjesë në operacionet për reagim ndaj krizave, operacionet në mbështetje të paqes, apo për t’i ndihmuar autoritetet civile;

- 2.2. përzgjidhet për të marr pjesë në trajnime të specializuara, nëse miratohet nga Ministri i FSK-së”.
3. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së mund të mobilizohen maksimalisht një vit për secilën periudhë kohore lëvizëse tri (3) vjeçare.
  4. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së nuk ka kufizime territoriale gjatë shërbimit. Sipas urdhrit, mund të kërkohet të shërbejë në territorin e Kosovës dhe të zbarkohet jashtë saj.
  5. Rregullat për rekrutimin e Rezervës së FSK-së janë të njëjta sikur ato që zbatohen për pjesëtarët aktivë të FSK-së. Ministri i FSK-së miraton procedurat e rekrutimit për Rezervën e FSK-së.
  6. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së është në detyrë kur udhëton për trajnim ose nga trajnimi, nga ushtrimet, operacionet ose kur është i mobilizuar.
  7. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së në detyrë, është pjesëtar aktiv i FSK-së dhe i nënshtrohet të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të FSK-së në fuqi, përfshirë Kodin Disiplinor dhe Kodin e Mirësjelljes së FSK-së.
  8. Pjesëtarit të Rezervës së FSK-së, për periudhën e angazhimit të tij në FSK duhet t'i bëhet një raport vlerësues vjetor në pajtim me Rregulloren mbi Vlerësimet vjetore të pjesëtarëve të FSK-së.

## **Neni 6**

### **Të drejtat individuale të pjesëtarit të Rezervës së FSK-së**

1. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së, kur është në detyrë, ka të njëjtat të drejta individuale sikurse pjesëtari aktiv i FSK-së, ashti siç përcaktohet në nenin 3 të Ligjit për Shërbim në FSK,
2. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së ka të drejtë në punësim primar jashtë FSK-së.
3. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së nuk humb punësimin e rregullt për shkak të mobilizimit apo kërkesës për të marr pjesë në trajnimin vjetor në Rezervën e FSK-së .
4. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së e ka të drejtën e pagesës në MFSK për kohën sa është në detyrë. Pagesa e tij llogaritet mbi baza ditore në shumën e njëjtë siç paguhen pjesëtari aktivë i FSK-së i të njëjtës gradë, në pajtim me Rregulloren mbi Pagat e FSK-së.
5. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së realizon pagën nga punëdhënësi primar si dhe nga FSK-ja për tridhjetegjashtë (36) ditët e detyrës vjetore.
6. Gjatë mobilizimit apo trajnimit të specializuar, punëdhënësi primar mund të ndalojë së paguari pagën për kohëzgjatjen e shërbimit të mobilizuar apo trajnimit.

7. Punëdhënësi primar nuk obligohet që ti jap pushim shtesë pjesëtarit të Rezervës së FSK-së, që të angazhohet në Rezervën e FSK-së,
8. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së ka të drejtë të parashtrijë ankesë në pajtim me Rregulloren e FSK-së për Shqyrtimin dhe Zgjidhjen e Ankesave.
9. E drejta për pensionin e pjesëtarëve rezervë të FSK-së rregullohet me dispozita përkatëse për pensionimin e pjesëtarëve të FSK-së.
10. Në raste të paafësisë ose vdekjes që rezulton për shkak të detyrës në FSK, pjesëtari i Rezervës së FSK-së trajtohet sipas dispozitave përkatëse për pjesëtarët aktiv të FSK-së.

## **Neni 7** **Përgjegjësitë individuale**

1. Personat të cilët aplikojnë për Rezervën e FSK-së duhet ta njoftoj punëdhënësin e tyre primar.
  - 1.1. punëdhënësi primar nënshkruan formularin e njoftimit rreth përgjegjësisë të tij, që parashihen me këtë ligj;
  - 1.2. formulari i njoftimit do të jetë pjesë e aplikimit në Rezervën e FSK-së.
2. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së, gjatë kohës sa është në detyrë aktive, bart të gjitha përgjegjësitë individuale, siç përcaktohen në nenin 4 të Ligjit për Shërbim në FSK.
3. Përfshirë nga paragrafi 2 i këtij neni, neni 4.1 (j) i Ligjit për Shërbim në FSK nuk vlen për pjesëtarët e Rezervës së FSK-së.
4. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së duhet ta bart uniformën vetëm kur është në detyrë ose gjatë kohës kur shkon apo kthehet nga detyra.
5. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së, bart armët e tij, në përputhje me Rregulloren mbi bartjen dhe përdorimin e armëve nga FSK.
6. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së nuk jep deklarata publike lidhur me FSK-në në pajtim me Udhëzimin Administrativ për dhënien e Informatave dhe Komunikimin me Media për pjesëtarët e MFSK-së dhe FSK-së.

## **Neni 8** **Mobilizimi**

1. Pjesëtari i Rezervës së FSK-së është i obliguar t'i përgjigjet thirrjes për angazhim dhe mobilizim.

2. Presidenti i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me Qeverinë dhe Kuvendin, urdhëron mobilizimin e pjesëtarëve të Rezervës së FSK-së.
3. Nëse pjesëtari i Rezervës së FSK-së thirret për angazhim apo mobilizim, punëdhënësi i tij primar ka obligim ta lirojë nga puna pjesëtarin e Rezervës së FSK-së për periudhën e angazhimit apo mobilizimit..
4. Nëse pjesëtari i Rezervës së FSK-së mobilizohet, punëdhënësi primar ka obligim ligjor që ta kthej pjesëtarin në vendin e punës pas përfundimit të periudhës së mobilizimit.
5. Kushtet dhe procedurat për angazhim dhe mobilizim në Rezervën e FSK-së përcaktohen me rregullore të veçantë të nxjerr nga Ministri i FSK-së.

### **Neni 9**

#### **Kalimi nga Komponenti Rezervë në Aktivë dhe anasjelltas**

Pjesëtari i Rezervës së FSK-së, ka të drejtë për të kërkuar kalim nga komponenti rezervë në atë aktiv dhe anasjelltas. Kushtet dhe procedurat për kalim duhet të përcaktohen me Rregullore të veçantë të nxjerr nga Ministri i FSK-së.

### **Neni 10**

#### **Shkeljet**

1. Departamenti i Personelit në MFSK është i obliguar që ta njoftoj Inspektoratin e Punës, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për shkeljet e dispozitave të paragrafit 3. të nenit 6 dhe paragrafit 3. dhe 4. të nenit 8 të këtij ligji.
2. Punëdhënësit primar që nuk i përmbushin obligimet e tyre sipas paragrafit 3. të nenit 6 dhe paragrafit 3. dhe 4. të nenit 8 të këtij ligji, ndëshkohen me gjobë në vlerë prej dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5000) Euro.
3. Përveç ndëshkimit me gjobë, të paraparë me paragrafin 2. të këtij neni, punëdhënësi primar është i obliguar që pjesëtarin e Rezervës së FSK-së ta kthej në punë dhe t'ia bëjë kompensimin e pagës për ta mbuluar periudhën e për të cilën pjesëtari ka mbetur pa punë.

### **Neni 11**

#### **Aktet nënligjore**

Ministri i Forcës së Sigurisë, brenda dy (2) muajsh, nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e tij.

**Neni 12**  
**Hyrja në Fuqi**

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-213**  
**15 korrik 2010**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**